SGCG; SLC10A2; SLC25A15; STARP1; ZNF198; ACHM1; ARVD1; BCH; CTAA1; DAD1; DFNB5; EML1; GALC; GCH1; IBGC1; IGH@; IGHC group; IGHG1; IGHM; IGHR; IV; LTBP2; MJD; MNG1; MPD1; MPS3C; MYH6; MYH7; NP; NPC2; PABPN1; PSEN1; PYGL; RPGRIP1; SERPINA1; SERPINA3; SERPINA6; SLC7A7; SPG3A; SPTB; TCL1A; TGM1; TITF1; TMIP; TRA@; TSHR; USHLA; VP; ACCPN; AHO2; ANCR; B2M; BBS4; BLM; CAPN3; CDAN1; CDAN3; CLN6; CMH3; CYP19; CYP1A1; CYP1A2; DYX1; EPB42; ETFA; EYCL3; FAH; FBN1; FES; HCVS; HEXA; IVD; LCS1; LIPC; MY05A; OCA2; OTSC1; PWCR; RLBP1; SLC12A1; SPG6; TPM1; UBE3A; WMS; ABCC6; ALDOA; APRT; ATP2A1; BBS2; CARD15; CATM; CDH1; CETP; CHST6; CLN3; CREBBP; CTH; CTM; CYBA; CYLD; DHS; DNASE1; DPEP1; ERCC4; FANCA; GALNS; GAN; HAGH; HBA1; HBA2; HBHR; HBQ1; HBZ; HBZP; HP; HSD11B2; IL4R; LIPB; MC1R; MEFV; MHC2TA; MLYCD; MMVP1; PHKB; PHKG2; PKD1; PKDTS; PMM2; PXE; SALL1; SCA4; SCNN1B; SCNN1G; SLC12A3; TAT; TSC2; VDI; WT3; ABR; ACACA; ACADVL; ACE; ALDH3A2; APOH; ASPA; AXIN2; BCL5; BHD; BLMH; BRCA1; CACD; CCA1; CCZS; CHRN1; CHRNE; CMT1A; COL1A1; CORD5; CTNS; EPX; ERBB2; G6PC; GAA; GALK1; GCGR; GFAP; GH1; GH2; GP1BA; GPSC; GUCY2D; ITGA2B; ITGB3; ITGB4; KRT10; KRT12; KRT13; KRT14; KRT14L1; KRT14L2; KRT14L3; KRT16; KRT16L1; KRT16L2; KRT17; KRT9; MAPT; MDB; MDCR; MGI; MHS2; MKS1; MPO; MYO15A; NAGLU; NAPB; NF1; NME1; P4HB; PAFAH1B1; PECAM1; PEX12; PHB; PMP22; PRKAR1A; PRKCA; PRKWNK4; PRP8; PRPF8; PTLAH; RARA; RCV1; RMSA1; RP17; RSS; SCN4A; SERPINF2; SGCA; SGSH; SHBG; SLC2A4; SLC4A1; SLC6A4; SMCR; SOST; SOX9; SSTR2; SYM1; SYNS1; TCF2; THRA; TIMP2; TOC; TOP2A; TP53; TRIM37; VBCH; ATP8B1; BCL2; CNSN; CORD1; CYB5; DCC; F5F8D; FECH; FEO; LAMA3; LCFS2; ADH4; MAFD1; MC2R; MCL; MYP2; NPC1; SPPK; TGFBRE; TGIF; TTR; AD2; AMH; APOC2; APOE; ATHS; BAX; BCKDHA; BCL3; BFIC; C3; CACNA1A; CCO; CEACAM5; COMP; CRX; DBA; DDU; DFNA4; DLL3; DM1; DMWD; E11S; ELA2; EPOR; ERCC2; ETFB; EXT3; EYCL1; FTL; FUT1; FUT2; FUT6; GAMT; GCDH; GPI; GUSM; HB1; HCL1; HHC2; HHC3; ICAM3; INSR; JAK3; KLK3; LDLR; LHB; LIG1; LOH19CR1; LYL1; MAN2B1; MCOLN1; MDRV; MLLT1; NOTCH3; NPHS1; OFC3; OPA3; PEPD; PRPF31; PRTN3; PRX; PSG1; PVR; RYR1; SLC5A5; SLC7A9; STK11; TBXA2R; TGFB1; TNNT3; TYROBP; ADA; AHCY; AVP; CDAN2; CDPD1; CHED1; CHED2; CHRNA4; CST3; EDN3; EEGV1; FTLL1; GDF5; GNAS; GSS; HNF4A; JAG1; KCNQ2; MKKS; NBIA1; PCK1; PI3; PPCD; PPGB; PRNP; THBD; TOP1; AIRE; APP; CBS; COL6A1; COL6A2; CSTB; DCR; DSCR1; FPDMM; HLCS; HPE1; ITGB2; KCNE1; KNO; PRSS7; RUNX1; SOD1; TAM; ADSL; ARSA; BCR; CECR; CHEK2; COMT; CRYBB2; CSF2RB; CTHM; CYP2D6; CYP2D7P1; DGCR; DIA1; EWSR1; GGT1; MGCR; MN1; NAGA; NE2; OGS2; PDGFB; PPARA; PRODH; SCO2; SCZD4; SERPIND1; SLC5A1; SOX10; TCN2; TIMP3; TST; VCF; ABCD1; ACTL1; ADFN; AGMX2; AHDS; AIC; AIED; AIH3; ALAS2; AMCD; AMELX; ANOP1; AR; ARAF1; ARSC2; ARSE; ARTS; ARX; ASAT; ASSP5; ATP7A; ATRX; AVPR2; BFLS; BGN; BTK; BZX; C1HR; CACNA1F; CALB3; CBBM; CCT; CDR1; CFNS; CGF1; CHM; CHR39c; CIDX; CLA2; CLCN5; CLS; CMTX2; CMTX3; CND; COD1; COD2; COL4A5; COL4A6; CPX; CVD1; CYBB; DCX; DFN2; DFN4; DFN6; DHOF; DIAPH2; DKC1; DMD; DSS; DYT3; EBM; EBP; ED1; ELK1; EMD; EVR2; F8; F9; FCP1; FDPSL5; FGD1; FGS1; FMR1; FMR2; G6PD; GABRA3; GATA1; GDI1; GDXY; GJB1; GK; GLA; GPC3; GRPR; GTD; GUST; HMS1; HPRT1; HPT; HTC2; HTR2c; HYR; IDS; IHG1; IL2RG; INDX; IP1; IP2; JMS; KAL1; KFSD; L1CAM; LAMP2; MAA; MAFD2; MAOA; MAOB; MCF2; MCS; MEAX; MECP2; MF4; MGC1; MIC5; MID1; MLLT7; MLS; MRSD; MRX14; MRX1; MRX20; MRX2; MRX3; MRX40; MRXA; MSD; MTM1; MYCL2; MYP1; NDP; NHS; NPHL1; NROB1; NSX; NYS1; NYX; OA1; OASD; OCRL; ODT1; OFD1; OPA2; OPD1; OPEM; OPN1LW; OPN1MW; OTC; P3; PDHA1; PDR; PFC; PFKFB1; PGK1; PGK1P1; PGS; PHEX; PHKA1; PHKA2; PHP; PIGA; PLP1; POF1; POLA; POU3F4; PPMX; PRD; PRPS1; PRPS2; PRS; RCCP2; RENBP; RENS1; RP2; RP6; RPGR; RPS4X; RPS6KA3; RS1; S11; SDYS; SEDL; SERPINA7; SH2D1A; SHFM2; SLC25A5; SMAX2; SRPX; SRS; STS; SYN1; SYP; TAF1; TAZ; TBX22; TDD; TFE3; THAS; THC; TIMM8A; TIM1; TKCR; TNFSF5; UBE1; UBE2A; WAS; WSN; WTS; WWS; XIC; XIST; XK; XM; XS; ZFX; ZIC3; ZNF261; ZNF41; ZNF6; AMELY; ASSP6; AZF1; AZF2; DAZ; GCY; RPS4Y; SMCY; ZFY; ABAT; AEZ; AFA; AFD1; ASAH1; ASD1; ASMT; CCAT;

CECR9; CEPA; CLA3; CLN4; CSF2RA; CTS1; DF; DIH1; DWS; DYT2; DYT4; EBR3; ECT; EEF1A1L14; EYCL2; FANCB; GCSH; GCSL; GIP; GTS; HHG; HMI; HOAC; HOKPP2; HRPT1; HSD3B3; HTC1; HV1S; ICHQ; ICR1; ICR5; IL3RA; KAL2; KMS; KRT18; KSS; LCAT; LHON; LIMM; MANBB; MCPH2; MEB; MELAS; MIC2; MPFD; MS; MSS; MTATP6; MTCO1; MTCO3; MTCYB; MTND1; MTND2; MTND4; MTND5; MTND6; MTRNR1; MTRNR2; MTTE; MTTG; MTTI; MTTK; MTTL1; MTTL2; MTTN; MTTP; MTTT1; NAMSD; OCD1; OPD2; PCK2; PCLD; PCOS1; PFKM; PKD3; PRCA1; PRO1; PROP1; RBS; RFXAP; RP; SHOX; SLC25A6; SPG5B; STO; SUOX; THM; dhe TTD.

## **TRANSFERIMI I PRONËSISË**

( 11) 5656

( 21 ) AL/P/ 2016/30

( 54) MBULESE PER NJE PAJISJE PER QELLIME MJEKESORE

( 97 ) EP2575590 / 16/12/2015

( 73 ) KEYMED (MEDICAL & INDUSTRIAL EQUIPMENT) LIMITED

KeyMed House,Stock Road,Southend-On- Sea,SS2 5QH,, GB

( 74 ) Gentjan Hasa

Rruga "Besim Alla" Pallati Dilo, Shkalla 2, Ap 25, Yzberisht, Tirane

( 11) 8750

( 21 ) AL/P/ 2019/719

( 54) Metoda e prodhimit te një produkti ushqimor të teksturuar dhe vete produkti ushqimor i teksturuar

( 97 ) EP3361880 / 14/08/2019

( 73 ) valio Oy

Meijeritie 6,00370 Helsinki,, FI

( 74 ) Eno DODBIBA

RR."Naim FRASHERI" P.60/3, Shk.1, Ap.16, Tiranë

**NDRYSHIMI I ADRESËS SË PRONARIT/APLIKANTIT**

( 11) 5656

( 21 ) AL/P/ 2016/30

( 54) MBULESE PER NJE PAJISJE PER QELLIME MJEKESORE

( 97 ) EP2575590 / 16/12/2015

( 73 ) KEYMED (MEDICAL & INDUSTRIAL EQUIPMENT) LIMITED

KeyMed House,Stock Road,Southend-On- Sea,SS2 5QH,, GB

( 74 ) Gentjan Hasa

Rruga "Besim Alla" Pallati Dilo, Shkalla 2, Ap 25, Yzberisht, Tirane

( 11) 9864

( 21 ) AL/P/ 2021/9

( 54) PROCES TRAJTIMI HIDROMETALURGJIK PËR EKSTRAKTIMIN E ELEMENTËVE TË CMUAR, BAZË DHE TË RRALLË

( 97 ) EP3418403 / 18/11/2020

( 73 ) Lifezone Limited

Commerce House,1 Bowring Road, Ramsey, IM8 2LQ,Isle of Man, Ebene, MU

( 74 ) Aleksandra Meçaj

Rr.Reshit Çollaku, Pall. Shallvare, Shk.5,Ap70/4 Tiranë, 100

**SKADIM I PATENTËS PËR MOSPAGESËN E  
RIPËRTËRITJES**



( 11 ) **5096**

( 97 ) /

( 96 ) /

( 21 ) AL/P/ 2014/372

( 22 ) 18/11/2014

( 54 ) PROJEKTI PËR MOTORRIN ME MAGNET TË PËRHERSHËM -SISTEMI MINERVINI

( 73 ) Michele Minervini

Acquaviva delle fonti BA, Via Seb.Di Chio 12, IT

( 74 ) Oronc Shpori

P.O Box 8308 Tirane, ALBANIA

( 11 ) **6378**

( 97 ) EP2953656 / 09/11/2016

( 96 ) 14708662.3 / 04/02/2014

( 21 ) AL/P/ 2017/75

( 22 ) 06/02/2017

( 54 ) DERIVATET E FOTO-NDËRLIDHURA TË ACIDIT HIALURONIK, PROCESI I GATITJES  
DHE PËRDORIMI I TYRE

( 73 ) Fidia Farmaceutici S.p.A.

Via Ponte della Fabbrica 3/A, 35031 Abano Terme (PD), IT

( 74 ) Ditika HOXHA

Rr." Emin Duraku" , Pall.6/1, Ap.4-02 Tiranë, Shqipëri

## **MODELE PËRDORIMI TË LËSHUAR**

( 11 ) 11

( 97 ) /

( 96 ) /

( 22 ) 30/09/2021

( 21 ) AL/U/ 2021/2

( 54 ) **Disifektant inteligjent i duarve (Smart Hand Clean S.H.C)**

15/09/2022

( 30 )

( 71 ) Artion Beqiraj

Lagjia 18, Rr "Kristo Sotiri", Blloku "Jeta e re", Durrës, AL

( 72 ) NOEL BEQIRAJ (Lagjia 18, Rr "Kristo Sotiri", Blloku "Jeta e re", Durrës)

( 74 ) Artion Beqiraj

Lagjia 18, Rr "Kristo Sotiri", Blloku "Jeta e re", Durrës

( 57 )

### **Abstrakti (Historiku i shpikjes)**

Shpikja adreson domosdoshmërinë e minimizimit të ngarkesës bakteriale në ambjentet e operatorëve ekonomikë, të cilët operojnë në industrinë e perpunimit të produkteve ushqimore, të transporteve publike (tragete, trena, avionë, etj). Gjithashtu shumë e vlefshme për ambjentet publike të frekuentuara nga një numër i lartë personash, si shkolla, laboratorë mjekësorë, spitale, institucione, etj. Duke qene se ulja e ngarkesës bakteriale, nuk është vetëm çështje e lidhur me sigurinë ushqimore, por është edhe çështje kostoje për operatorët, çështje sigurie fizike për punonjësit e tyre, si dhe kushtëzimi në organizimin e punës, sepse dizinfektimet e ambjenteve të mbyllura duhen bërë pa praninë e punonjësve dhe marrin kohë të vlefshme. Përveç sa me lartë, shpikja është një ndihmë posacerisht edhe për ndotjen e ambjenteve të mbyllura, sepse të anulosh ngarkesën bakteriale në një ambient të mbyllur, e shpërndarë kjo nga rrymat e ajrit në çdo cep të tij, është tejet e vështirë dhe kërkon kohë dhe sasi të madhe dizinfektantesh.

Për rrjedhojë ulja e ngarkesës bakteriale që prej jashtë ambjenteve dmth të rrisesh sigurinë ushqimore, të ulësh kostot e higjienizimit, të mos cenosh eficienten e kompanive dhe të garantosh një ambient të higjienizuar. Duke qene se Coronavirus është gjithsesi një mikrob dhe duke konstatuar rritjen e ndjeshmerisë në publik ndaj nevojës së uljes së ngarkesës mikrobike, shpikësi prezanton këtë aplikim si eksperience risi, por edhe me potencial evolucionari përkundërt rrethanave dhe nevojave të ndryshme, edhe nepermjet implementimit të funksioneve shtesë.

### **Pershkrimi dhe Objekti i shpikjes**

Një paisje në inox, e projektuar në mënyrë të atillë dhe me komponente të përshtatshëm, që të qëndrojnë dhe funksionojnë në ambient të hapur dhe që, nepermjet programimit të hapave dhe zgjidhjeve teknike, të higjienizojë shojet e këpucëve dhe duart brënda një sekuence të shkurtër dhe të programuar ciklesh, me kosto shumë të ulët për cikël. Paisja është përshtatshme për zgjerimin e funksioneve të saj edhe me skanimin e trupit, me qëllim higjienizimin, nëpërmjet instalimit të një llampe UVC, të menaxhuar nga software-i i kontrollit. Gjithashtu mund t'i instalohet një skaner i temperaturës trupore, duke e kthyer atë në një stacion polivalent funksionesh për higjienizimin dhe sigurinë shëndetësore të individit dhe publikut. Aplikanti prezanton një model përdorimi i cili, nepermjet zgjidhjeve teknike të avancuara dhe materialeve të sigurta, i certifikuar CE, garanton uljen e ngarkesës mikrobike në mënyrë të matshme dhe me fokus në shpejtësinë e veprimit, uljen e kostove për subjektet përdoruese, diskrecionin kundërt përdoruesit, sigurinë dhe komoditetin në përdorim, mungesën e impaktit negativ në mjedis.

Nga kqyrja e vizatimeve, figura 1, figura 2, figura 3 dhe figura 4, mund të konstatohet:

- a- Ekuilibri i paisjes, qendrueshmëria e saj përkundërt përplasjes me të;
- b- Siguria për të mos u dëmtuar në rast përpalsjeje fizike me të;
- c- Ergonomia e paisjes;
- d- Fleksibiliteti në implementimin e funksioneve eventuale shtesë;

- e- Konstrukti i mbyllur, që garanton jetëgjatësinë e elementeve përberës elektrikë dhe elektronikë, si dhe sigurinë fizikë të përdoruesit ndaj qarkut elektrik;
- f- Thjeshtësia e furnizimit me lëngjet dizinfektuese, pa vënë në rrezik dëmtimin e komponentëve të ndryshëm;
- g- Komunikimi miqësor i paisjes me përdoruesin, nëpërmjet monitorit të vendosur në lartësi të përshtatshme;

Vizatimet




Figura 1 – pamje ballore




Figura 2 – pamje ne profil




Figura 3 – pamje nga larte




Figura 4 – pamje 3D

### Risia

Risia konsiston në mundësimin e higjenizimit, me rezultat të kontrollueshëm, nëpërmjet tamponit eventual, në laborator mikrobiologjik analizash, të shojeve të këpucëve dhe të duarve, në ambient të hapur.

### Pretendimet:

1. Një pajisje që karakterizohet nga: konstrukcion prej një materiali të cmuar, siç është inoksi 304, me një pedane të ndjeshme dhe stabil, që garanton një procesim të shpejtë dhe komod, me qëndrueshmëri ndaj goditjeve dhe shtytjeve, e cila është e mbyllur në të gjitha anët, për rrjedhojë e pacënueshme nga agjentet atmosferikë dhe pluhuri; si edhe nga një dritare komunikimi me përdoruesin, të përfaqësuar nga një ekran celulari 7" e që mundeson asistencë me remote control, nëpërmjet software-it dhe aksesit në internet.
2. Pajisje si në pretendimin 1, me të cilën kryhet procesi higjenizimit, e pajisur me elementet funksionale, si pompat dhe sensorët, të një cilësie të lartë dhe të certifikuar, e që mund të kryejë edhe procesin e monitorimit të temperaturës së përdoruesve apo të një dizinfektimi akoma me të gjërë, nëpërmjet implementimit të një llampe UVC si edhe përdorimit të substancave disinfektuese, të sugjeruara, miqësore me ambientin dhe njeriun, të certifikuara ndërkombëtarisht.
3. Pajisje, si në pretendimet 1 dhe 2, e cila funksionon në ambient të hapur, me rezultate të matëshme të uljes së ngarkesës mikrobike të përdoruesit, përpara se ky të hyjë në ambiente të mbyllura, e

montueshme dhe e zmontueshme shpejte dhe thjeshtësisht, pa patur nevojë për teknikë të specializuar, me siguri kundrejt anomalive elektrike apo përplasjes aksidentale me paisjen;

4. Paisje, si ne pretendimet 1, 2 dhe 3 e tillë që, ashtu siç është konceptuar ne funksionim me komandim prej nje qarku elektronik dhe nje software, te projektuar dhe të prodhuar ad hoc, si dhe të certifikuar, qe siguron perdoruesin ne eficencën e saj, duke qënë se substancat higjenizuese nuk humbasin eficencën e tyre, si rrjedhojë e kalimit nga perdoruesit pararendës.



**APLIKIME KOMBËTARE PËR PATENTË**

(22) 09/08/2021

(21) AL/P/ 2021/584

(54) **PRODHIM BETONI QË TRANSMETON DRITËN PËR PLLAKA DYSHEMEJE PER INTERIERE DHE EXTERIERE DUKE PËRDORUR TEKNOLOGJINË E PRINTIMIT TRE-DIMENSIONAL**

(30)

(71) Fiordi Pernaska

Rr."Mihal Grameno", nr.55., AL

(72) Fiordi Pernaska (Rr."Mihal Grameno", nr.55.)

(55)

(57)

(22) 08/09/2021

(21) AL/P/ 2021/652

(54) **Pajisje dhe metode qe perdor frymenxjerrjen presive te ajrit nga goja e perdoruesit per te mundesuar gjimnastiken e mushkerive dhe muskujve abdominale te perdoruesit.**

(30)

(71) EXINN Technology Center sh.p.k

Rruga Nexho Konomi, Rezenca Green City, PA4, Zyra 1, Tirana, Albania, AL

(72) Andrea Papa (Rr."Kont Urani, Nr.9, Tirane)

(55)

(57)

### **FUSHA TEKNIKE E SHKENCËS**

[001] Shpikja që zbulohet është një pajisje (100), që afron një metodë përdorimi e cila përshtatet plotësisht me fiziologjinë natyrale të funksionit të organeve të frymimit të përdoruesit, duke mundësuar fiskulturën e mushkërive, rritjen e oksigjenit në gjak, dhe ushtrimin e muskujve abdominale të përdoruesit, pa nevojën e instruksioneve ose trajnimeve specifike.

### **HISTORIKU I SHPIKJES**

[002] Me gjithë evoluimin e teknologjive, teknikave dhe metodave që përdoren sot në industrinë e paisjeve të frymëmarrjes dhe frymënxjerrjes, si dhe përdorimit të këtij procesi natyral për fiskulturën e mushkërive dhe muskujve abdominale të barkut, vërehet se këto risi shfaqin kufizime në funksion, efikasitet, praktikitet dhe produktivitet.

[003] Përgjithësisht këto pajisje duken të jenë të ngjashme në pamje por jo në funksion dhe metodë krahasuar me shpikjen e propozuar për patentë.

Pikërisht këto kufizime dhe dallime që do të trajtohen në vazhdim zvogëlojnë hapësirën për të reflektuar krahasime të dukshme me shpikjet e artit ekzistues.

[004] Në përgjithësi, pajisjet dhe metodat e risive të artit dhe produkteve ekzistuese shfaqin një kompleksitet në qasjen e zgjidhjes së problemeve që lidhen me frymëmarrjen dhe frymënxjerrjen e përdoruesve të ndryshëm.

[005] Më konkretisht, teknikat dhe metodat e përdorura sot janë dizenuar të orientojnë përdoruesin dhe organet e tij të frymimit që të përshtaten me metodat ose udhëzimet e këtyre pajisjeve, teksa duhet të jetë organizmi i përdoruesit ai që duhet të programojë operimin e paisjes në përputhje me fiziologjinë e

frymimit, gjëndjen fizike dhe atë shëndetësore të përdoruesit.

[006] Nga kërkimi dhe eksperiencia shumevjeçare e shpikesit në fushën teknike, si dhe nga statistikat e domaineve zyrtare të institucioneve të afirmuara në fushen teknike të shkencës, rezulton se mbi 50% e popullsisë botërore frymon me gojë dhe jo me hundë.

[007] Përgjithësisht pajisjet dhe metodat ekzistuese të artit janë fokusuar të suportojnë funksionin dhe metodën e frymëmarrjes dhe frymënxjerrjes nëpërmjet teknikave dhe metodave me anë të valvulave regjistruese.

[008] Këto valvula mund të sjellin një sërë kufizimesh që lidhen me shëndetin fizik, gjatë procesit të frymëmarrjes dhe frymënxjerrjes që mund të përfundojnë me kalimin e kohës në çrregullimin e ekuilibrit të performancës së shëndetit duke sjellë në sipërfaqe probleme të ndryshme shëndetësore.

[009] Më konkretisht, frymëmarrja e gabuar nëpërmjet gojës bëhet shkas për transmetimin në organizëm të mikrobeve ose viruseve të ndryshme që rezultojnë në sëmundje dhe imunitet të dobët.

[010] Fiziologjia e frymimit të njeriut nuk është projektuar apo krijuar për të marrë frymë me gojë, por me hundë, për t'i siguruar mushkërive lagështinë e duhur të ajrit për përthithjen e oksigjenit në nivelet e duhura. Diferenca e përthithjes së oksigjenit kur frymojmë me hundë është 20% më e lartë se kur frymojmë me gojë.

[011] Frymëmarrja dhe frymënxjerrja janë ndër proceset më të rëndësishme në funksionin fiziologjik dhe biologjik të trupit të njeriut. Teknikat e ndryshme të frymëmarrjes dhe frymënxjerrjes të risive aktuale janë dizenuar kryesisht për të mbuluar zgjidhjet komerciale, pa efijencë në cilësi dhe praktikitet.

[012] Kjo qasje e orientuar e kufizon aftësinë e shpiksave për të dizenuar funksionin e pajisjeve në mënyrë që ato të përdorin si metodë aplikimi përshtatjen e pajisjeve sipas funksionit fiziologjik të organeve të frymëmarrjes dhe frymënxjerrjes.

[013] Përshembull, paisjet aktuale të artit janë dizenuar që regjistrimet e valvulave të frymëmarrjes dhe frymënxjerrjes, si dhe presionet që ndodhin në organet e frymëmarrjes gjatë procesit të përdorimit të pajisjeve, të kryhen manualisht nga përdoruesi.

[014] Kjo qasje krijon kufizime të dukshme për përdoruesit, pasi është pothuajse e pamundur të përshtatësh regjistrimin e valvulave të frymimit sipas presioneve të organeve frymuese, teksa presioni i mushkërive gjatë ushtrimit fizik është gjithmonë në ndryshim të vazhdueshëm për përdorues me nevoja të ndryshme fizike.

[015] Më konkretisht, kompleksiteti i regjistrimit të valvulave nga përdoruesi gjatë gjimnastikës së mushkërive dhe muskujve abdominale, e vështirëson procesin e presionit të frymënxjerrjes dhe performancën totale të procesit.

[016] Organizmi i çdo njeriu shfaq nevoja të ndryshme të funksionit të organeve të tij të frymimit, teksa teknikat e pajisjeve ekzistuese e detyrojnë përdoruesin të ndalojë disa herë procesin e fiskulturës për të rregulluar regjistrimin e valvulave pa efijencë dhe produktivitet. Pikërisht këto kufizime bëhen me të dukshme gjatë përdorimit të pajisjeve nga përdoruesit me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe pleqtë.

[017] Një tjetër kufizim i pajisjeve të artit aktual është fakti që lagështia dhe kondesimi i ajrit gjatë procesit të frymimit ndodhin pikërisht tek valvulat e regjistrimit në formën e sekrecioneve, Këto sekrecione i shndërrojnë valvulat në vatra ku mund të grumbullohen papastërti dhe bakterie të

ndryshme.

[018] Kufizime të ndryshme mund të shfaqen në shëndetin e përdoruesit teksa pastrimi i valvulave nga sekrecionet mund të kërkojë një trajtim të veçantë pastrimi, me rezultat uljen e efikasitetit, cilësisë dhe praktikitetit të përdorimit të tyre.

[019] Përgjithësisht asnjë teknikë në art nuk mundëson një pajisje dhe metodë frymënxjerrjeje që të jetë dizenuar të përdorë avantazhet natyrale të procesit të frymënxjerrjes, për të stërvitur njëkohësisht mushkëritë dhe muskujt abdominale në përputhje me aftësitë dhe mundësitë shëndetësore dhe fizike të çdo përdoruesi në veçanti.

[020] Ndryshe nga pajisjet dhe teknikat ekzistuese, shpikja aktuale sjell një zgjidhje që buron nga identifikimi i problematikave të funksionit të aparatit të frymëmarrjes dhe muskujve abdominal tek njerëzit që nuk frymojnë në përputhje me fiziologjinë e organeve frymuese dhe jo vetëm. Si e tillë për mbulimin efektiv të këtyre nevojave, nevojitet një pajisje dhe metodë frymënxjerrjeje që të sigurojë cilësi, efikasitet, dhe praktikitet për përdoruesit gjatë procesit të ushtrimit të mushkërive, oksigjenimit të gjakut dhe muskujve abdominale.

### **PËRMBLEDHJE E SHPIKJES**

[021] Qëllimi kryesor i shpikjes i cili përkon edhe me udhëzimet e WHO për stërvitjen e mushkërive të pacientëve pas COVID-19 është të sigurojë një pajisje dhe metodë frymëmarrjeje dhe frymënxjerrjeje që mundëson tek përdoruesit njëkohësisht gjimnastikën e mushkërive, oksigjenimin e gjakut, muskujve abdominale të barkut, e deri tek të gjithë muskujt që kontrahohen gjatë procesit të aplikimit të shpikjes nga përdoruesit.

[022] Rritja e efikasitetit arrihet nga praktikiteti dhe përshtatja e shpikjes me fiziologjinë e organeve të frymimit të përdoruesit duke marrë frymë me hundë dhe duke nxjerrë frymë me gojë sipas presionit dhe mundësive të mushkërive të çdo përdoruesi në nivel të personalizuar.

[023] Gjithashtu rritja e efikasitetit arrihet nga eliminimi i mundësisë së përdoruesit për të marrë frymë me gojë duke e udhëzuar atë natyrshëm drejt metodës së marrjes së frymës me hundë dhe nxjerrjes së frymës me gojë me presion, sipas nevojave të mushkërive të përdoruesit.

[024] Një qëllim tjetër i shpikjes është të sigurojë një pajisje dhe metodë e cila ta vetë-edukojë përdoruesin duke mësuar nga eksperiencia dhe vetëdija e krijuar për të kryer saktë procesin e frymimit dhe duke përjetuar në kohë reale rritjen e cilësisë së shëndetit fizik, mendor dhe shpirtëror.

[025] Kjo arrihet nëpërmjet dizajnit të pajisjes dhe sistemit elastik të frymënxjerrjes, i cili është projektuar të ushtrojë një funksion që përshtatet me nevojat fiziologjike dhe fizike të çdo përdoruesi në nivel të personalizuar, të cilat vëzhgohen nga përdoruesi në kohë reale përmes sensorit matës të trupëzuar në dorën e përdoruesit.

[026] Një qëllim tjetër i shpikjes është që të sigurojë një metodë praktike aplikimi e cila nuk kufizohet për asnjë grupmoshë, duke filluar nga mosha 5 vjeç e sipër.

[027] Kjo arrihet duke siguruar sisteme elastike të dizenuara me trashësi të ndryshme muresh dhe rezistencë në elasticitet, të cilat mundësojnë zgjerimin dhe ngushtimin ciklik të sistemit elastik në nivele presionesh përdorimi, të ulta, të mesme dhe të larta sipas grupmoshave dhe aftësive të përdoruesve.

[028] Një tjetër qëllim i shpikjes është të ndihmojë kategoritë e përdoruesve me aftësi të kufizuara për të përmirësuar shëndetin e mushkërive, oksigjenimin e gjakut, muskujve abdominale, duarve dhe krahëve të tyre.

[029] Kjo arrihet përmes përdorimit të aksesorëve ndihmues në duart e përdoruesit, të cilat i mundësojnë atij koherencën maksimale të performancës së fiskulturës gjatë presionit të frymënxjerrjes për të mundësuar efikasitet në oksigjenimin e gjakut dhe stërvitjen e mushkërive dhe muskujve aktiv në këtë proces.

[030] Një qëllim tjetër i shpikjes është të sigurojë një pajisje e cila të pastrohet lehtë me praktikitet dhe produktivitet.

[031] Kjo arrihet përmes dizajnit të pajisjes dhe sistemit elastik i cili është projektuar të mos ketë njësi që inkorporojnë valvula regjistruese të frymimit me gojë.

[032] Këto karakteristika së bashku me avantazhe të tjera që karakterizojnë shpikjen, arrihen nga një pajisje dhe metodë ku karakteristikat kryesore siç përcaktohen në pretendimet e deklaruara, do të bëhen të dukshme me ekzaminimin e përshkrimit të detajuar pasues të trupëzimeve të preferuara, ku referenca dhe numrat u përgjigjen elementëve përkatës në të gjithë përshkrimin.

### **PËRSHKRIMI I SHKURTËR I DIZAJNIT.**

[033] Figura. 1, paraqet një pamje të përgjithshme të pajisjes (100) para aplikimit të saj nga përdoruesi gjatë një trupëzimi të shpikjes të përbërë nga sistemi elastik (50), që përmban të paktën një unazë të sipërme (51) dhe të paktën një sfinkter elastik fundor (52) që përfshin të paktën një vrimë rrethore (53), dhe pjesa gojore (30) e pajisjes (100) që përmban kanalën e brendshme (32) të daljes së frymës (20), i cili përfundon në formën e një sfinkteri elastik parësor (33) poshtë fundit (31) të unazës së jashtme fundore.

[034] Figura. 2, paraqet një pamje të plote të pajisjes (100) gjatë operimit nga përdoruesi, ku tregohet progresivisht zmadhimi i sistemit elastik (50) dhe fiskultura e muskujve abdominale (10) të përdoruesit nga presioni i ushtruar i ajrit të mushkërive në sistemin elastik (50) gjatë çdo cikli të procesit të frymënxjerrjes.

[035] Figura. 3, paraqet aksesorët (12) dhe (13) në duart e përdoruesit gjatë aplikimit të metodës në përputhje me nevojat e tij

### **PËRSHKRIMI I DETAJUAR I TRUPËZIMEVE TË PREFERUARA**

[036] Shpikja e propozuar në tërësinë e saj, përfshin një pajisje frymënxjerrjeje (100) Figura. 1, që mund të trupëzohet për të kryer funksionin e saj në përputhje me aplikimet e preferueshme, për t'i shërbyer një spektri sa më të gjerë përdoruesish me dhe pa nevoja specifike.

[037] Pajisja e frymënxjerrjes (100) është projektuar të aplikohet në mënyrën më të thjeshtë të mundshme nga përdoruesi, pa qenë nevoja të instruktohet apo trajnohet me informacion udhëzues ose kompleks. Metoda që aplikuesi përjeton gjatë procesit të frymënxjerrjes me pajisjen (100) është e njëjtë me procesin natyral të marrjes frymë me hundë dhe nxjerrjes së frymës me gojë me presion gjatë procesit të frymës së tullumbaces.

[038] Ky është edhe qëllimi kryesor i shpikësit, të krijojë një pajisje dhe një metodë frymimi dhe

gjimnastikimi të mushkërive, muskujve abdominal dhe muskujve të duarve të përdoruesve, e cila përshtatet dhe operon në përputhje me fiziologjinë, nevojat dhe mundësitë fizike dhe shëndetësore të përdoruesit.

[039] Risia identifikohet në dizajnin funksional të saj, ku pajisja (100) figura. 1, përdor si mjet bllokimi të marrjes frymë me gojë, sistemin elastik (50) dhe sfinkterin elastik parësor (33), duke e udhëzuar përdoruesin natyrshëm të marrë frymë me hundë dhe të frymojë ajrin jashtë me gojë përmes kanalit të brendshëm (32) të pjesës gojore (30) të pajisjes (100), ku ajri presiv (20) përmes sfinkterit parësor elastik (33) përfundon në brendësi të sistemit elastik (50).

[040] Siç tregohet në figurën. 1, dhe 2, ajri presiv (20), i ushtruar në brendësi të sistemit elastik (50) përmes sfinkterit elastik parësor (33), mundësohet brenda sistemit elastik (50), duke e detyruar sistemin elastik (50) të kryejë një zgjerim progresiv radial. Zgjerimi radial i mureve të sistemit elastik (50) fillon të kufizohet, kur ajri presiv i rritur brenda sistemit elastik (50) fillon të aktivizojë zgjerimin e vrimës rrethore (53) të sfinkterit elastik fundor (52) të sistemit elastik (50), duke mundësuar daljen e ajrit nga brendësia e sistemit elastik (50) jashtë sistemit elastik (50).

[041] Siç u deklarua edhe në përmbledhjen e shpikjes, ajo që zbulohet është një pajisje (100), që afron një metodë përdorimi që përshtatet plotësisht me fiziologjinë natyrale të funksionit të organeve të frymimit të përdoruesit, duke mundësuar, fiskulturën e mushkërive, rritjen e oksigjenit në gjak, dhe ushtrimin e muskujve abdominale të përdoruesit, pa nevojën e instruksioneve ose trajnimeve specifike.

[042] Më specifikisht, zgjerimi dhe ngushtimi radial ciklik i sistemit elastik (50), arrihet nga presioni i ajrit ose frymës ciklike (20) që del nga mushkëritë e përdoruesit nëpërmjet gojës, i cili përfundon në brendësi të sistemit elastik (50), ku nëpërmjet zgjerimit dhe ngushtimit të sfinkterit elastik parësor (33) dhe zgjerimit dhe ngushtimit të vrimës rrethore (53) të sfinkterit elastik fundor (52), arrin vetë - rregullimin e performancës së funksionit të pajisjes (100) dhe sistemit elastik (50), në përshtatje me mundësitë fizike, mendore dhe shëndetësore të çdo përdoruesi specifik.

[043] Gjatë çdo cikli frymimi, përdoruesi merr frymë me hundë dhe nxjerr frymë me gojë sipas fiziologjisë së frymëmarrjes së tij natyrale, duke mos u kufizuar në zgjedhjet e frymëmarrjes dhe frymëdaljes me hundë dhe gojë ose vetëm me hundë përveçse frymëmarrjes me gojë.

[044] Gjatë ciklit të frymënxjerrjes me gojë, përdoruesi detyrohet të ushtrojë presionin e frymës që del prej mushkërive për të zgjeruar hapjen e sfinkterit elastik parësor (33), ku përmes tij presioni i ajrit ose frymës, shkon për të zgjeruar ose fryrë sistemin elastik (50).

[045] Pas të paktën 2 - 3 ciklesh frymimi brenda sistemit elastik (50), presioni i rritur i ajrit brenda tij fillon të aktivizojë vrimën rrethore (53) të sfinkterit elastik fundor (52) ku përmes tij çlirohet dalja ciklike e ajrit (20) jashtë sistemit elastik (50).

[046] Kur sfinkteri elastik parësor (33) i pajisjes (100) ndodhet në fazën e pauzës së ciklit të frymënxjerrjes nga përdoruesi, atëherë presioni i ajrit ose frymës që ndodhet brenda sistemit elastik (50) mbyll sfinkterin elastik parësor (33) të pajisjes (100).

[047] Presioni i ajrit (20) të bllokuar brenda sistemit elastik (50), gradualisht fillon të shkarkohet jashtë sistemit elastik (50) përmes vrimës rrethore (53) në sfinkterin elastik fundor (52) të tij, ku vrima rrethore (53) e sfinkterit elastik fundor (52) ciklikisht zgjerohet dhe mbyllet në përputhje me ciklet e frymimit dhe presionin e ajrit (20) të ushtruar nga përdoruesi.

[048] Gjatë procesit ciklik të zgjerimit progresiv dhe ngushtimit regresiv të sistemit elastik (50) presioni i frymënxjerrjes së mushkërive aktivizon muskuj abdominale (10) të barkut të përdoruesit Figura. 2, të cilët

detyrohen të kryejnë cikle kontraktimi sipas presionit që mushkëritë ushtrojnë në brendësi të sistemit elastik (50) për ta zgjeruar.

[049] Në trupëzime specifike Figura. 3, pajisja (100) mund të shoqërohet me aksesoret fleksibël elastik (12) të cilët i mundësojnë përdoruesit të stervisë njëkohësisht duart dhe krahët e tij, si dhe të suportojnë procesin e kryerjes së ushtrimeve abdominale dhe monitorimin e nivelit të oksigjenimit të mushkërive në kohë reale, përmes sensorit matës (13).

[050] Funkzioni i shpikjes, siç portretizohet në Figurën. 1, 2, dhe 3, mund të sigurohet sipas trupëzimeve të ndryshme të pajisjes (100), sistemeve elastike (50) aksesoreve (12) dhe (13) në përputhje me aplikimet e preferuara duke siguruar një spektër të gjerë aplikimesh për përdorues të ndryshëm.

[051] Pajisja (100) e propozuar për shpikje mund të prodhohet prej materialesh rigjide të kategorisë së lejueshme për përdorim gojor dhe medical. Sistemi elastik (50) mund të prodhohet nga materiale rigjide elastike një ose shumë përdorimshe sipas preferencave të trupëzimeve të aplikueshmërisë dhe përdorueshmërisë.

Referencat e trupëzimeve dhe shpikja aktuale janë të kufizuara vetëm nga pretendimet që deklarohen në vazhdim.

### **PRETENDIMET:**

Shpikja e pretenduar është:

1- Pajisje frymënxjerrjeje (100) që vendoset në gojën e përdoruesit, përmban të paktën një sfinkter elastik parësor (33) që përfundon në brendësi të sistemit elastik (50), i cili përmban të paktën një sfinkter elastik fundor (52) që përfshin të paktën një vrimë shkarkuese (53) të ajrit (20).

2- Pajisje (100) që përmban të paktën një unazë të jashtme bashkuese (31) me unazën (51) të sistemit elastik (50).

3- Pajisje (100) që përmban të paktën një sfinkter elastik parësor (33) për futjen e frymës/ajrit (20) brenda sistemit elastik (50).

4- Pajisje (100) që përmban të paktën një sfinkter elastik parësor (33) për të ndaluar rikthimin e frymës/ajrit (20) nga brendësia e sistemit elastik (50) në brendësi të gojës.

5- Pajisje (100) që trupëzon një sistem elastik (50) i cili përmban të paktën një sfinkter elastik fundor (52) që përfshin të paktën një vrimë (53), për nxjerrjen ciklike të frymës/ajrit (20) jashtë sistemit elastik (50).

6- Një metodë përdorimi e pajisjes së frymënxjerrjes (100), përmes sistemit elastik (50) dhe përmes hapave të mëposhtëm, i mundëson përdoruesit ndalimin e frymëmarrjes me gojë duke e udhëzuar drejt frymëmarrjes së detyruar me hundë dhe frymënxjerrjes së ajrit (20) me gojë përmes sfinkterit parësor (33) që ndodhet në brendësi të sistemit elastik të zgjerueshëm (50), që përmban të paktën një sfinkter elastik fundor (52), që përfshin të paktën një vrimë shkarkuese (53) të ajrit (20), siguron ciklikisht zgjerimin dhe tkurrjen radiale të sistemit (50) gjatë procesit natyral të frymimit, duke mundësuar fiskulturën e mushkërive, muskujve abdominal, duarve dhe krahëve të përdoruesit dhe oksigjenimin maksimal të gjakut.

**ABSTRAKT.**

Shpikja që paraqitet, lidhet me një pajisje frymënxjerrjeje (100) dhe një metodë frymimi që siguron nxjerrjen e ajrit presiv (20) të mushkërive nga goja e përdoruesit përmes sfinkterit parësor (33) në brendësi të sistemit elastik (50), i cili në mënyrë radiale progresivisht dhe regresivisht zgjerohet dhe tkurret ciklikisht përmes sfinkterit elastik fundor (52) që përfshin të paktën një vrimë shkarkuese (53) të ajrit (20), ku në përputhje me sasinë e ajrit që mushkëritë nxjerrin përmes gojes gjatë çdo cikli frymënxjerrjeje siguron fiskulturen e mushkërive, muskujve abdominale të përdoruesit, dhe oksigjenimin maksimal të gjakut për çdo cikël frymëmarrjeje me hundë dhe frymënxjerrjeje me gojë.






Fig. 1





Fig. 2

100



**Fig. 3**

(22) 13/09/2021

(21) AL/P/ 2021/666

(54) **Sistem dhe metodë që përdor hapjen dhe mbylljen ciklike të pëllëmbëve të duarve dhe gishtave të përdoruesit për të mundësuar gjimnastikën e muskujve të tyre.**

(30)

(71) EXINN Technology Center sh.p.k

Rruga Nexho Konomi, Rezidenca Green City, PA4, Zyra 1, Tirana, Albania, AL

(72) Andrea Papa (Rr."Kont Urani, Nr.9, Tirane)

(55)

## **FUSHA TEKNIKE E SHKENCËS**

[001] Shpikja që zbulohet është një sistem dhe metodë që përdor hapjen dhe mbylljen ciklike të pëllëmbëve të duarve dhe gishtave të përdoruesit për të mundësuar gjimnastikën e muskujve të tyre.

## **HISTORIKU I SHPIKJES**

[002] Metodatat dhe teknikat që përdoren sot në industrinë e procesit të pajisjeve të fiskulturës së muskujve të duarve dhe gishtave të përdoruesve, shfaqin kufizime që lidhen me funksionin, efikasitetin, praktikitetin dhe produktivitetin.

[003] Përgjithësisht këto pajisje duken të jenë të ngjashme në pamje por jo në funksion dhe metodë krahasuar me shpikjen e propozuar për patentë.

Pikërisht këto kufizime dhe dallime që do të trajtohen në vazhdim zvogëlojnë hapësirën për të reflektuar krahasime të dukshme me shpikjet e artit ekzistues.

[004] Në përgjithësi, pajisjet dhe metodat e risive të artit dhe produkteve ekzistuese shfaqin një kompleksitet në qasjen e zgjidhjes së problemeve që lidhen me fiskulturën e duarve dhe gishtave të përdoruesve.

[005] Më konkretisht, teknikat dhe metodat e përdorura sot, janë dizenuar të orientojnë gishtat e përdoruesit që të përshtaten me metodat ose udhëzimet e këtyre pajisjeve, teksa duhet të jenë duart dhe gishtat e përdoruesit ato që duhet të orientojnë operimin e pajisjeve në përputhje me fiziologjinë dhe aftësinë e përdoruesit.

[006] Kjo qasje e orientuar e kufizon aftësinë e shpiksave për të dizenuar funksionin e pajisjeve në mënyrë që ato të përdorin si metodë aplikimi përshtatjen e pajisjeve sipas funksionit fiziologjik të duarve dhe gishtave të përdoruesit.

[007] Përdorues të ndryshëm shfaqin nevoja të ndryshme të rregullimit të pozicionit të gishtave përkundrejt pajisjeve përdoruese, duke kufizuar praktikitetin, efikasitetin dhe produktivitetin e operimit. Këto kufizime bëhen më të dukshme kryesisht gjatë përdorimit të pajisjeve nga përdoruesit me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe pleqtë.

[008] Përgjithësisht teknikat e përdorura në art nuk mundësojnë një pajisje dhe metodë fiskulture të duarve dhe gishtave që të jenë të dizenuara të përdorin avantazhet natyrale të procesit të hapjes dhe mbylljes së pëllëmbave, për të stërvitur njëkohësisht gishtat dhe gjithë muskujt e krahëve në përputhje me aftësitë dhe mundësitë shëndetësore dhe fizike të çdo përdoruesi në veçanti.

[009] Ndryshe nga pajisjet dhe teknikat ekzistuese, shpikja aktuale sjell një zgjidhje që buron nga identifikimi i problematikave të funksionit të gishtave të përdoruesve. Si e tillë për mbulimin efektiv të këtyre nevojave, nevojitet një sistem dhe metodë që të sigurojë cilësi, efikasitet, dhe praktikitet për përdoruesit gjatë procesit të fiskulturës së gishtave dhe muskujve të duarve.

### **PËRMBLEDHJE E SHPIKJES**

[010] Qëllimi kryesor i shpikjes është të sigurojë një sistem dhe metodë fiskulture që mundëson tek përdoruesit njëkohësisht gjimnastikën e gishtave dhe muskujve të duarve gjatë procesit të aplikimit të shpikjes nga përdoruesit.

[011] Rritja e efikasitetit arrihet nga praktikiteti dhe përshtatja e shpikjes me fiziologjinë e lëvizjes së gishtave dhe muskujve të duarve dhe krahëve të përdoruesit në mënyrë ciklike në nivel të personalizuar.

[012] Një qëllim tjetër i shpikjes është të sigurojë një sistem dhe metodë e cila ta vetë-edukojë përdoruesin duke mësuar nga eksperiencia dhe vetëdija e krijuar për të kryer saktë procesin e fiskulturës së gishtave dhe duarve në funksion të rritjes së cilësisë së shëndetit të tij fizik.

[013] Kjo arrihet nëpërmjet dizajnit të sistemit rigjid, elastik/ fleksibël, i cili është projektuar të ushtrojë një funksion që përshtatet me nevojat fiziologjike dhe fizike të çdo përdoruesi në nivel të personalizuar.

[014] Një qëllim tjetër i shpikjes është që të sigurojë një metodë praktike aplikimi e cila nuk kufizohet për asnjë grupmoshë, duke filluar nga mosha 5 vjeç e sipër.

[015] Kjo arrihet duke siguruar sisteme elastike/fleksibël të dizenuara me përmasa të ndryshme dhe rezistencë në elasticitet dhe fleksibilitet, të cilat mundësojnë tkurrjen dhe zgjerimin ciklik të sistemit

elastik/fleksibël për nivele të ndryshme përdorimi, sipas grupmoshave dhe aftësive të përdoruesve.

[016] Një tjetër qëllim i shpikjes është të ndihmojë kategoritë e përdoruesve me aftësi të kufizuara për të përmirësuar shëndetin e gishtave, muskujve të duarve dhe krahëve të tyre.

[017] Kjo arrihet përmes dizajnit të sistemit elastik/fleksibël dhe foleve praktike të pozicionimit të gishtave, të cilat i mundësojnë përdoruesit koherencën maksimale të performancës së fiskulturës së gishtave dhe muskujve aktivë të duarve dhe krahëve gjatë operimit.

[018] Këto karakteristika së bashku me avantazhe të tjera që karakterizojnë shpikjen, arrihen nga një sistem dhe metodë ku karakteristikat kryesore siç përcaktohen në pretendimet e deklaruara, do të bëhen të dukshme me ekzaminimin e përshkrimit të detajuar pasues të trupëzimeve të preferuara, ku referenca dhe numrat u përgjigjen elementëve përkatës në të gjithë përshkrimin.

### **PËRSHKRIMI I SHKURTËR I DIZAJNIT.**

[019] Figura. 1, paraqet një pamje të përgjithshme të sistemit elastik/fleksibël (100), gjatë një trupëzimi të shpikjes të përbërë nga një sferë fleksibël qendrore (40), që përfshin të paktën një vrimë frymuese të sferës (41), ku sfera (40) rrethohet nga një diametër i jashtëm fleksibël (50) që përmban të paktën pesë fole simetrike fleksibël (51) të vendosjes së gishtave (30) të përdoruesit, ku zonat e sipërme të foleve (51) përfshijnë të paktën dhjetë amortizatorë kufizues (52) të rikthimit ciklik të sistemit (100) nga pozicioni i tkurrjes në atë të zgjerimit .

[020] Figura. 2, paraqet një pamje nga lart të sistemit (100) dhe elementeve të tij.

[021] Figura. 3, paraqet një pamje të elementeve të sistemit (100) gjatë operimit ciklik nga gishtat e përdoruesit, ku përmes shigjetave (54) tregohet cikli i tkurrjes/ngjeshjes së sferës (40), dhe përmes shigjetave (53) tregohet rikthimi/zgjerimi i sferës (40) në pozicionin fillestar të ciklit të operimit.

### **PËRSHKRIMI I DETAJUAR I TRUPËZIMEVE TË PREFERUARA**

[022] Shpikja e propozuar në tërësinë e saj, përfshin një sistem rigjid, elastik/fleksibël (100) Figura. 1, që mund të trupëzohet për të kryer funksionin e saj në përputhje me aplikimet e preferueshme, për t'i shërbyer një spektri sa më të gjerë përdoruesish me dhe pa nevoja specifike.

[023] Sistemi rigjid, elastik/fleksibël (100) është projektuar të aplikohet në mënyrën më të thjeshtë të mundshme nga përdoruesi, pa qenë nevoja që ai të instruktohet apo trajnohet me informacion udhëzues ose kompleks. Metoda që aplikuesi përjeton gjatë procesit të fiskulturës së gishtave me sistemin (100), është i njëjtë me procesin natyral të hapjes dhe mbylljes së pëllëmbëve dhe gishtave të duarve kur ato shtrëngohen për të përqëndruar me shume forcë tek gishtat, duart dhe muskujt e krahëve.

[024] Qëllimi kryesor i shpikësit është të krijojë një sistem dhe metodë gjimnastikimi të gishtave dhe muskujve të duarve dhe krahëve të muskujve të përdoruesve, e cila përshtatet dhe operon në përputhje me fiziologjinë, nevojat dhe mundësitë fizike dhe shëndetësore të gishtave dhe duarve të përdoruesve.

[025] Risia identifikohet në dizajnin funksional të saj, Figura. 1, ku pëllëmbët dhe gishtat e përdoruesit përdorin tkurrjen dhe zgjerimin e sistemit (100) dhe sferës (40) përmes ngjeshjes së gishtave (30) në foletë e tyre (51) duke i udhëzuar gishtat (30) e përdoruesit natyrshëm të tentojnë të mblidhen dhe hapen gjatë cdo cikli gjimnastikimi.

[026] Siç tregohet në Figurën. 1, çdo sistem (100) vendoset në pëllëmbët e duarve të përdoruesit, ku 5 gishtat e çdo pëllëmbë pozicionohen në 5 foletë përkatëse (51) që ndodhen midis diametrit të madh të jashtëm të sistemit (100) që rrethon ose mbështjell diametrin më të vogël të sferës qendrore fleksibël (40). Sistemi operon në një cikël ngjeshje/tkurrije dhe zgjerimi/rikthimi të sistemit (100) dhe sferës qendrore (40), ku diametri i vogël i sferës (40) është projektuar të suportojë madhësinë e pëllëmbës së dorës së përdoruesit për performancë maksimale gjatë operimit.

